



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 12809 Prot.

Lezhë, më 05 . 04 . 2021

VENDIM

Nr. 110 Datë 29 . 06 . 2021

“Për miratim të listës paraprake të pronave të paluajtshme që kërkohet të transferohen në pronësi të Bashkisë Lezhë.”

Mbështetur në ligjin numër 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9 pika 1.2 germa a, në ligjin nr 8743 datë 22.02.2001 “Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit” neni 8 i ndryshuar, në Ligjin nr 8744 date 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 2, Neni 4, Neni 6, Neni 7, Neni 8, Neni 9, Neni 11, Neni 12, në Ligjin nr 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Seksioni IV, në Ligjin nr 111/2018 “Për Kadastrën” Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, në Ligjin nr 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, neni 24, në Udhëzimin nr 30 dt 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (i ndryshuar), në Udhëzimin nr 15 dt 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, në VKM nr 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore” si dhe në Udhëzimin nr 3 datë 18.07.2002 të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit “Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme të Shtetit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore”, duke qenë se ky proces është i papërfunduar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pjeshme të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohet të transferohen në pronësi apo përdorim të Njësisë Administrative Dajç -Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë.

a. Lista e inventarit bashkëngjitur, Fshati Kotërr, Nj. A. Dajç, Bashkia Lezhë.

2. Paraqitjen e listës së pjeshme paraprake për miratim në Këshillin e Ministrave.

3. Ngarkohet Sektori i Menaxhimit të Aseteve dhe Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI

ERNEST RAKAJ

I. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHËTËTORËRE

(Për Inventarizimin e Pronave të Vecanta)

BASHKIA LEZHË, NJ. A. DAIÇ		Identifikoi		Ing. Nderim Muça. (Topograf) (Emër, Mbiemër, Pozicioni Zyrtar)						
		Supervizoi		Genian Maloraj (Drejtori i Zyrës Juridike & S.M.A.) (Emër, Mbiemër, Pozicioni Zyrtar)						
		Aprovoi		Pjerin Ndreu (Kryebashkiaku) (Emër, Mbiemër, Pozicioni Zyrtar, firma, vullë)						
Fusha e Përdorimit të Pronës : Bujqësi										
A			B			C				
Nr rendor	Zona Kadastrale & Indeksit i Hartës	Nr i Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës, Adresa	Sip. Totale e Pronës (m ²)	Nga Sip. Totale sa Ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilën Përdoret Prona	Institucioni / Enti me Përgjegjësi Administrative	Statutacioni / Entiteti Përdorues, Statusi Juridik i Përdorimit	Te dhëna të tjera (Shënime të Vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	2246 K-34-76-(37-C)	100	Arë	Arë, Fshati Kotër	43'618	0	Arë	Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural	Bashkia Lezhë	